REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 704 Prot.    Tiranë, më 09.07.2019

**UDHËZIM**

**Nr. 04, datë 09.07.2019**

**PËR**
**REALIZIMIN E PROCESIT TË NISJES, KONSULTIMIT, BASHKËRENDIMIT DHE MIRATIMIT TË DOKUMENTEVE TË PLANEVE TË DETAJUARA VENDORE (*PDV*) NËPËRMJET REGJISTRIT KOMBËTAR TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT - SISTEMI ELEKTRONIK *E-PLANIFIKIMI***

Në mbështetje të nenit 28, të Ligjit Nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", neneve 3, 9, 13, 22, 23, 24, 25, 55, 56 dhe 57 të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Kreut III të VKM-së Nr. 427, datë 08.06.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit", neneve 2, 3, 4, 5, 6, 9, 10, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 81 të VKM-së Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Realizimin e procesit të nisjes, konsultimit, bashkërendimit dhe miratimit të dokumenteve të Planeve të Detajuara Vendore (PDV) nga autoritetet vendore të planifikimit nëpërmjet Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit – sistemi elektronik *e-planifikimi* – duke filluar nga data **29 Korrik 2019.**

2. Gjatë periudhës 29 Korrik 2019 – 30 Gusht 2019, procesi i nisjes, konsultimit, bashkërendimit dhe miratimit të dokumenteve të Planeve të Detajuara Vendore nga autoritetet vendore do të realizohet nëpërmjet sistemit elektronik *e-planifikimi,* me mbështjetjen dhe asistencën teknike të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

3. Duke filluar nga data **02 Shtator 2019**, procesi i nisjes, konsultimit, bashkërendimit dhe miratimit të dokumenteve të Planeve të Detajuara Vendore nga autoritetet vendore do të realizohet vetëm nëpërmjet sistemit elektronik *e-planifikimi.*

4. Aksesi në sistemin elektronik *e-planifikimi* nga autoritetet vendore realizohet nga llogaritë dhe kredencialet e tyre përkatëse, nëpërmjet linkut: http://172.24.35.4:81/. Për të siguruar aksesin në sistemin elektronik *e-planifikimi* është e detyrueshme lidhja me VPN. Llogaritë dhe Kredencialet, të cilat janë përdorur deri më tani nga autoritetet vendore, për aksesin në Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit, do të zëvendësohen/përdoren nga Llogaritë dhe Kredencialet për aksesin në sistemin elektronik *e-planifikimi*.

5. Autoritetet Vendore përgjegjëse për hartimin e dokumentit të Planit të Detajuar Vendor, duhet të sigurojnë transparencë për publikun e gjerë, përgjatë këtij procesi, nëpërmjet botimit të dokumentit (draft) të PDV-së dhe realizimit të takimeve publike, në rast se kërkohen, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fushën e planifikimit të territorit. Procesi i botimit të draftit dhe njoftimit të konsultimit publik duhet të realizohet nëpërmjet RKPT-së – sistemit elektronik *e-planifikimi.*

6. Pjesë integrale e këtij Udhëzimi janë:

- Shtojca I "Manuali i përdorimit të Sistemit *e-planifikimi për PDV-në*", ku përcaktohet në mënyrë të detajuar mënyra e aksesimit dhe përdorimit të sistemit *e-planifikimi* me funksionalitetet e tij;
- Shtojca II "*Modeli i të dhënave GIS për PDV-në*".

7. Ngarkohen Autoritet Vendore që kanë nisur hartimin e Planeve të Detajuara Vendore dhe gjenden në Hapin I, për rinisjen e procesit në sistemin elektronik *e-planifikimi*, duke ringarkuar Dokumentin për ndërmarrjen e Nismës.

8. Ngarkohen Autoritetet Vendore, të cilat ndërmarrin nismën për hartimin e dokumenteve të Planeve të Detajuara Vendore më datë 29 Korrik 2019 e në vijim, si dhe AKPT, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi.

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**

**Adelina GRECA**

AKPT
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

ikubINFO
Software Engineering

# e-planifikimi / PDV

## Manuali i Përdoruesit

Tiranë, 09.07.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA KOMBETARE E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

## Tabela e Përmbajtjes

Shpjegues i Termave ..... 3
Hyrje ..... 4
Hyrja në sistem ..... 6
Rrjedha e punës për procesin e Planit të Detajuar Vendor ..... 8
Rolet kryesore në rrjedhën e punës ..... 8
Kryetari i Bashkisë ..... 10
Ndërmarrja e Nismës ..... 10
Miratimi i PDV-së ..... 20
Grupi i Punës në Bashki ..... 26
Hartimi i PDV-së ..... 26
Botimi i draftit përfundimtar ..... 28
Dëgjesa – Nisma ..... 32
Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) ..... 36
Shqyrtimi i PDV-së ..... 36

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË

**Shpjegues i Termave**

- AKPT: Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
- PDV: Plan i Detajuar Vendor
- Sistemi elektronik "e-Planifikimi": ndërfaqe e integruar në rrjet, pjesë e Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT), për të gjithë proceset e planifikimit të territorit, sipas legjislacionit në fuqi, e cila realizon ndërveprimin e të gjithë institucioneve të përfshira në proces, si institucionet qëndrore dhe ato vendore;
- Kredenciale: të dhënat e llogarisë për hyrje në sistem;
- Rol: përdoruesit e RKPT, të cilët kanë të drejtën e aksesit, hedhjes dhe përdorimit të informacionit në Regjistër;
- Proces: të gjithë fazat në të cilën kalon hartimi/miratimi i dokumentit të planifikimit;
- Fazë: Një pjesë e procesit të hartimit të një dokumenti planifikimi, ku përgatitet një/disa nga dokumentet përbërëse të tij, e cila finalizohet me pranimin/konfirmimin/pëlqimin e dokumentit të planifikimit të hartuar për atë faze, sipas përcaktimeve të rregullores së planifikimit të territorit;
- Botim: ngarkimi i materialeve në sistemin e-Planifikimi / Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT).

## Hyrje

Sistemi për planifikimin e territorit në Shqipëri menaxhon proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, të cilat ndërmerren nga autoritetet e planifikimit në nivel qendror e vendor.

Nëpërmjet këtij sistemi realizohen funksionalitetet e mëposhtme:

- Ndërmarrja e nismave, propozimi për miratim KKT-së dhe krijimi i procedurave të detajuara për këtë nismë, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Planifikimit.
- Kontroll i përputhshmërisë së akteve të botuara në regjistër, me ligjet dhe dokumentet e planifikimit, etj.

Qëllimi i këtij manuali është udhëzimi i të gjithë përdoruesve që kanë të drejtë të aksesojnë dhe përdorin sistemin. Çdo përdorues identifikohet në mënyrë unike në sistem sipas kredencialeve të pajisura nga administratori i sistemit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
TIRANË




*Figura 1*

## Hyrja në sistem

Për të aksesuar sistemin, përdoruesit duhet të jenë të pajisur me kredencialet e siguruara nga administratori i sistemit.

Për autentifikimin, përdoruesi duhet të plotësojë fushat '*Emri i përdoruesit*' dhe '*Fjalëkalimi*' dhe të klikojë mbi butonin '*OK*'.

Në Figurën 1 paraqitet ndërfaqja e identifikimit në sistem.

# PDV




*Figura 2*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

**Rrjedha e punës për procesin e Planit të Detajuar Vendor**

Hapat e procesit të punës për PDV-në janë si më poshtë:

1. **Marrja e Nismës** për hartimin e PDV-së
2. **Botimi i dokumenteve** të PDV-së për konsultim publik dhe shqyrtim përputhshmërie
3. **Shqyrtimi i përputhshmërisë** së PDV-së
4. **Miratimi i PDV-së** dhe hyrja në fuqi e dokumenteve

+ **Organizimi i dëgjesës** publike në rast se kërkohet.
  *Ky hap realizohet në mënyrë të pavarur nga hapat e mësipërm.*

**Rolet kryesore në rrjedhën e punës**

1. **Kryetari i Bashkisë**

Roli "Kryetari i Bashkisë" është një rol vendimmarrës.

Ky rol merr pjesë në hapin e parë, ku ndërmerr nismën për hartimin e Planit të Detajuar Vendor (PDV), si edhe në hapin final, kur miraton ose refuzon/kthen për rishikim dokumentet e Planit të Planit të Detajuar Vendor (PDV).

2. **Grupi i punës**

Ky rol është përgjegjës për hartimin e dokumenteve të Planit të Detajuar Vendor, përditësimin e tyre në sistem, si dhe thirrjen e Dëgjesës për konsultime publike mes palëve të interesuara, në rastet kur kërkohet, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

3. **AKPT**

Roli AKPT është përgjegjës për monitorimin e hartimit të dokumenteve të PDV-së në përputhje me PPV-në dhe legjislacionin në fuqi, si edhe për të siguruar transparencë dhe informim për publikun.

Roli AKPT kryen verifikimin e dokumenteve të botuara nga roli "Grup pune", gjatë afatit 30 ditor, kur dokumentet janë të botuara për njohje nga publiku dhe palët e interesuara.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA




*Figura 3*




*Figura 4*

**Kryetari i Bashkisë**

Roli "Kryetari i Bashkisë" është një rol vendimmarrës.

Ky rol merr pjesë në hapin e parë, ku ndërmerr nismën për hartimin e Planit të Detajuar Vendor (PDV), si edhe në hapin final, kur miraton ose refuzon/kthen për rishikim dokumentet e Planit të Planit të Detajuar Vendor (PDV).

Pasi përdoruesi me rolin e specifikuar autentifikohet në sistem, atij i shfaqet pamja si në Figurën 3.

**Ndërmarrja e Nismës**

Shqyrtimi i aplikimeve për PDV-në, për rolin Kryetari i Bashkisë, bëhet si vijon:

- Përdoruesi zgjeron nyjen PDV duke klikuar mbi butonin '+'.
- Në zgjerim të nyjes 'PDV', shfaqen të gjitha fazat që nyja përmban, si në Figurën4:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA




*Figura 5*




*Figura 6*




*Figura 7*

- Në klikim të nyjes 'Nisma' shfaqet lista me nismat e reja, si në Figurën 5.
- Nëse përdoruesi (roli Kryetari i Bashkisë) dëshiron të krijojë një nismë të re, klikon butonin *"Ndërmerr nismën"*.
- Në klikim të tij hapet dritarja për plotësimin e të dhënave të nismës së re, si në Figurën 6.
- Pasi përdoruesi plotëson fushën "Përshkrim i aplikimit" dhe fushën "Njësia Strukturore" si në Figurën 7, klikon butonin *"Konfirmo fillimin e nismës"*.




Figura 8




Figura 9




Figura 10

- Pas klikimit të butonit, përdoruesit i shfaqet një dritare e re që i tregon se ku do të shkojë aplikimi, si në Figurën 8.
- Në klikim të butonit *"Kalo Proçesin tek "Botimi i dokumentave të nismës – Roli Kryetar Bashkie"* të kësaj dritareje, aplikimi kalon tek nyja Nisma.
- Pasi mbyllet dritarja, nisma e sapo krijuar shtohet në listë si në Figurën 9.
- Nëse klikojmë nismën e sapo krijuar, hapet dritarja *"Botimi i dokumentave të nismës"*, ku përdoruesi duhet të shtojë dokumentin mbi vendimin për ndërmarrjen e Nismës, si dhe të përzgjedhë Grupin e Punës për këtë nismë, si në Figurën 10.

REPUBLIKA E SHQIPERISË AGJENCIA KOMBETARE E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT TIRANE SEKRETAR




*Figura 11*




*Figura 12*

- Për shtimin e dokumentave, përdoruesi klikon butonin *"Shto një rekord te ri"* dhe hapet dritarja për shtimin e një dokumenti.
- Në klikim të butonit *"Bashkëngjit"* realizohet ngarkimi i dokumentit dhe më pas bëhet plotësimi i fushave të tjera si "Subjekti", "Përshkrimi" dhe *"Komente"*, si në Figurën 11.
- Pasi ngarkohet dokumenti dhe plotësohen fushat me të dhënat e tij – *"Subjekti", "Pershkrimi", "Komente"* – përdoruesi klikon butonin *"Më tej"*.
- Në klikim të këtij butoni mbyllet dritarja për shtimin e të dhënave të dokumentit dhe dokumenti i sapo krijuar shfaqet në listë.
- Gjithashtu përzgjidhet dhe grupi i punës për këtë nismë, si në Figurën 12.


Kalo ne hapin tjeter
Botimi i dokumentave - Roli Kryetar Bashkie
Botimi i dokumentave te nismes
Kalo Proçesin tek: - 'Boto draftin perfundimtar - Roli Grupi Punes'

*Figura 13*

- Përdoruesi klikon butonin *"Më tej"* dhe nisma kalon në hapin tjetër - *"Kalo Proçesin tek: Boto draftin përfundimtar – Roli Grupi i Punës"* – si në Figurën 13.

Me këtë veprim, përfundon përgjegjësia e rolit Kryetari i Bashkisë, përsa i përket hapit të ndërmarrjes së nismës.

Ky veprim e çon procesin tek Grupi i Punës.

Në vijim do të jepen shpjegime për rolin Kryetari i Bashkisë në hapin e miratimit të PDV-së.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA




*Figura 14*




*Figura 15*

**Miratimi i PDV-së**

- Në klikim të nyjes "Miratimi i PDV" shfaqet lista me të gjithë aplikimet PDV që janë për vendimmarrje nga roli Kryetari i Bashkisë, si në Figurën 14.

  Të gjithë aplikimet që ndodhen në këtë listë kanë ardhur nga roli Grupi i Punës, i cili, sipas rastit ka ndërmarrë, ose jo, një dëgjesë për çdo PDV dhe në përfundim të tyre ka botuar dokumentet e nevojshme për to.

  Dokumentet e PDV-së kalojnë tek roli Kryetari i Bashkisë vetëm në përfundim të afatit 30 ditor, në dispozicion për njohjen e publikut dhe grupeve të interesit.

- Në klikim të një prej rekordeve hapet një dritare e re me titullin *"Të dhënat e PDV-së"* si në Figurën 15.

  Këtu mund të shihen të gjitha dokumentat e ngarkuara nga Grupi i Punës që bën kërkesën për miratimin e PDV-së nga Kryetari.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA




*Figura 16*




*Figura 17*

- Në klikim të butonit *"Më tej"* të dritares *"Të dhënat e PDV-së"* në Figurën 14, hapet një dritare që i jep mundësinë rolit të Kryetarit të Bashkisë të marrë një vendim mbi PDV-në në proces, si në Figurën 16.
- Pasi Kryetari i Bashkisë ndërmerr një vendim për PDV-në, atij do t'i shfaqet një dritare e re, e cila i jep mundësinë të ngarkojë dokumentin e vendimmarrjes dhe dokumentet e PDV-së, të nënshkruar elektronikisht, si në Figurën 17.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA




Figura 18




Figura 19

- Për shtimin e dokumentave, përdoruesi klikon butonin *"Shto nje rekord te ri"* dhe hapet dritarja për shtimin e një dokumenti.
- Në klikim të butonit *"Bashkëngjit"* realizohet ngarkimi i dokumentit dhe më pas bëhet plotësimi i fushave të tjera si *"Subjekti"*, *"Përshkrimi"* dhe *"Komente"*, si në Figurën 18.
- Pasi ngarkohet dokumenti dhe plotësohen fushat me të dhënat e tij – "*Subjekti*", *"Përshkrimi"*, *"Komente"* – përdoruesi klikon butonin *"Më tej"*.
- Në klikim të këtij butoni shfaqet një PopUp, sikurse tregohet në Figurën 19, i cili e paralajmeron Kryetarin e Bashkisë se veprimi që po kryen nuk mund të anullohet, pasi do të klikojë "OK".
- Në klikim të butonit "OK" përfundon shqyrtimi i plotë dhe miratimi i një PDV-je të hartuar nga Grupi i Punës.

***Sqarim:**

Në rast se Roli **Kryetar i Bashkisë** merr një vendim negativ për një PDV, atëherë kjo PDV do i kalojë përsëri për shqyrtim rolit **Grupi i Punës në Bashki.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA




Figura 20




Figura 21




Figura 22

**Grupi i Punës në Bashki**

Ky rol është përgjegjës për ngarkimin e dokumenteve të Planit të Detajuar Vendor, përditësimin e tyre në system, si dhe thirrjen e Dëgjesës për konsultime publike mes palëve të interesuara, në rastet kur kërkohet, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Pasi perdoruesi me rolin e specifikuar autentifikohet në sistem, atij i shfaqet pamja sikurse tregohet në Figuren 20.

**Hartimi i PDV-së**

Ngarkimi i dokumenteve të PDV-së për rolin Grupi i Punës në Bashki bëhet si vijon:

Përdoruesi zgjeron nyjen PDV duke klikuar mbi butonin '+'. Në zgjerim të nyjes 'PDV', shfaqen të gjitha fazat që nyja përmban, si në Figurën 21 (paneli majtas).

Nyja përmban dy faza:

1. Dëgjesa - Nisma
2. Botimi i Draftit Përfundimtar

Nëse përdoruesi klikon mbi butonin *"Dëgjesa"* atij do t'i shfaqet lista e nismave/ PDV-ve për të cilat janë rregjistruar kërkesa për realizimin e dëgjesave publike, sipas legjislacionit në fuqi, si në Figurën 20 (paneli djathtas).

Nëse përdoruesi klikon mbi butonin *"Botimi i Draftit Përfundimtar"* atij do t'i shfaqet lista e nismave/ PDV-ve, të cilat janë ende në proces hartimi, apo rishikimi/plotësimi, sikurse tregohet në Figurën 22.


Te dhenat e nismes
Boto draftin perfundimtar - Roli Grupi Punes
Botimi i dokumentave
Te dhena per nismen
Application Type
PDV
Numri i nismes
20190623_PDV0123
Data e fillimit
6/23/2019
Application Description
TEST_PDV
Dokumentat e ngarkuara
Dokumenti
Pershkrimi
Data e ngark
20190623_Bashkia Krujë_PDV_Njesia_Strukturore_44/1_Njoftim_V1
Dokumenti i njoftimit të ni
6/23/2019
1 of 1 selected (found 1)
Next
Close

*Figura 23*

**Botimi i draftit përfundimtar**

Në klikim të nyjes *"Botimi i draftit përfundimtar"* shfaqet lista me të gjitha nismat e ndërmarra nga Kryetari dhe që ndodhen tek Grupi i Punës për shqyrtim, si në figurën 22, e cila u shpjegua më sipër.

Në klikim të një Nisme do të hapet një dritare që do të shfaqë të dhënat mbi nismën/ PDV-në, si edhe dokumentat e ngarkuara për atë nismë/ PDV, sikurse tregohet në Figurën 23.

* **Sqarim:** Nëse përdoruesi do të klikojë mbi emrin e dokumentit ai do t'i shkarkohet në kompjuterin personal, nga ku ka mundësinë për të parë përmbajtjen e dokumentit.




*Figura 24*




*Figura 25*

Në klikim të butonit *"Më tej"* do të shfaqet dritarja *"Boto draftin përfundimtar"*, ku user-i mund të shohë dokumentat e ngarkuar për këtë nismë/ PDV, si edhe të ngarkojë dokumentet e nevojshme për hapin në të cilin ndodhet procesi i PDV-së, sikurse tregohet në Figurën 24.

Përdoruesi duhet të ngarkojë nga një dokument për secilën nyje:

1. *Plani i Përcaktimeve Territoriale - Dokumentet e Raportit*
2. *Plani i Përcaktimeve Territoriale - Dokumentet e Hartave*
3. *Rregullorja e Planit të Detajuar - Dokumentet e Raportit*
4. *Shapefile (sipas datamodelit të PDV-së)*

Në klikim të butonit *"Më tej"* do të shfaqet një dritare e re, ku përdoruesit i kërkohet të marrë një vendim, nëse dëshiron ta kalojë aplikimin në hapin tjetër, drejt rolit **AKPT**, sikurse tregohet në Figurën 25.

***Sqarim**

Në rast se përdoruesi do të zgjedhë opsionin Po **PDV** do të kalojë në rolin **AKPT,** dhe roli **Grupi Punës në Bashki** nuk do të ketë më mundësi të kryejë veprime mbi këtë **PDV**, përveç rasteve kur PDV do të kthehet për plotësim nga roli AKPT apo Kryetari i Bashkisë.

Në rast se përdoruesi do të zgjedhë opsionin Jo **PDV** do të qendrojë tek po ky rol pa ndonjë kufizim afati, derisa vetë përdoruesi që e ka në ngarkim hartimin e PDV-së të vendosë t'ia kalojë atë për shqyrtim rolit pasardhës (**AKPT**).




Figura 26




Figura 27

**Dëgjesa – Nisma**

Dëgjesa është opsionale sipas rastit kur kërkohet.

Ky hap është i pavarur në sistem dhe nuk penalizon apo frenon rrjedhën e procesit të hartimit të Planit të Detajuar Vendor.

Kërkesa nga qytetarët apo grupet e interesit merret në rrugë shkresore, pra jashtë sistemit e-planifikimi.

- Në klikim të nyjes *"Dëgjesa - Nisma"* shfaqet lista me të gjitha dëgjesat e reja për nismat e ndërmarra nga Kryetari, si në figurën 26, sikurse shpjeguar edhe në hyrje të këtij kapitulli.
- Në klikim të butonit *"Ndërmerr Dëgjesën"* do të shfaqet një dritare e re, e cila mundëson që roli Grupi i Punës të ngritjen e një dëgjesë të re për një nismë të ndërmarrë nga Kryetari, mbi bazën e kërkesës së banorëve apo grupeve të interesit, sikurse tregohet në Figurën 27.

  Në këtë dritare, ngritja e një dëgjese të re bëhet duke vendosur numrin e saktë të nismës.




Figura 28




Figura 29




Figura 30

- Në klikim të butonit "*Më tej*", hapet një dritare e re, "*Aplikimi i Dëgjesës*", në të cilën roli Grupi i Punës duhet të plotësojë të gjitha të dhënat për organizimin e dëgjesës për Nismën/ PDV-në e publikuar, sikurse tregohet në Figurën 28.

- Njoftimi i dëgjesës do të bëhet publik në website të AKPT-së (dhe Bashkisë, pasi të realizohet lidhja automatike me sistemin e-planifikimi).

  Në këtë dritare jepet mundësia për të ngarkuar dokumentat për dëgjesën publike që po ndërmerret, përveç atyre që janë të botuara tashmë për PDV-në.

- Pasi Dëgjesa për një Nismë të jetë realizuar dhe të jenë shqyrtuar kërkesat/ sugjerimet e qytetarëve dhe grupeve të interesit, user-i i këtij roli mund të kalojë në hapin tjetër, Figura 29, dhe të ngarkojë dokumentin mbi Raportin Përfundimtar të kësaj dëgjese duke klikuar mbi rekordin e Dëgjeses përkatëse, sikurse tregohet në Figurën 30.

  Raporti Përfundimtar është një dokument, ku reflektohen sipas rastit propozimet e palëve pjesëmarrëse në Dëgjesën Publike të mbajtur.

- Me ngarkimin në sistem të Raportit Përfundimtar të Dëgjesës së organizuar dhe, në klikim të butonit "*Më tej*" përfundon me sukses dhe procesi i dëgjesës për nismën e ndërmarrë.

* Ky hap i mëtejshëm mund të shoqërohet me një botim të rishikuar të PDV-së, ose jo, në varësi të Raportit Përfundimtar të Dëgjesës, në rastet kur aplikimi nuk ka kaluar në hapin e shqyrtimit nga AKPT.

Në rastet kur dëgjesa kryhet kur aplikimi gjendet në periudhën e shqyrtimin nga AKPT, apo të miratimit nga Kryetari, dhe duhet të kryhet ribotim, ai do të mund të kryhet vetën pasi AKPT apo Kryetari do të refuzojnë aplikimin dhe ta rikthejnë në hapin -"*Boto Draftin Perfundimtar-Roli Grup i Punes*".



Figura 31



Figura 32




Figura 33

**Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)**

Roli AKPT është përgjegjës për monitorimin e hartimit të dokumenteve të PDV-së në përputhje me PPV-në dhe legjislacionin në fuqi, si edhe për të siguruar transparencë dhe informim për publikun.

Roli AKPT kryen verifikimin e dokumenteve të botuara nga roli "Grup pune", gjatë afatit 30 ditor, kur dokumentet janë të botuara për njohje nga publiku dhe palët e interesuara.

Pasi përdoruesi me rolin e specifikuar autentifikohet në sistem, atij i shfaqet pamja sikurse tregohet në Figurën 31.

**Shqyrtimi i PDV-së**

Shqyrtimi i aplikimeve për **PDV** bëhet si vijon:

- Përdoruesi zgjeron nyjen **PDV** duke klikuar mbi butonin '+'. Në zgjerim të nyjes '**PDV**', shfaqen të gjitha fazat qe nyja përmban, si në Figurë 32.
- Në klikim të një PDV-je do të shfaqet dritarja me dokumentet e këtij aplikimi dhe detajet më kryesore të PDV-së, si në Figurën 33.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
TIRANË




Figura 34




Figura 35

- Në klikim të butonit *"Më tej"* do të shfaqet një dritare e re me titullin *"Akti i Përputhshmërisë"*, ku përdoruesit i kërkohet të marrë një vendim mbi aplikimin, nëse do i japë përputhshmërinë, apo do e refuzojë, si në Figurën 34.

- Në varësi të mendimit që do japë roli **AKPT**, atij do t'i shfaqet një dritare e re ku duhet të ngarkojë dokumentin mbi të cilin do të argumentojë mendimin e dhënë, si në Figurën 35.

***Sqarim**: Edhe pas dhënies së përputhshmërisë, ose jo, aplikimi do të qëndrojë tek po ky rol derisa të ketë përfunduar afati prej 30 ditësh pë konsultim të draftit me publikun e gjerë. Këtë afat do të ketë paralelisht në dispozicion edhe roli **AKPT**.

Nga momenti që ky aplikim ka ardhur tek ky rol, do të thotë se brenda këtij afati ky rol mund të bëjë ndryshime të vlerësimit të tij, në varësi të të rejave që mund të shfaqen në sistem, si psh Raporti Përfundimtar i Dëgjesës (nëse do të ketë një të tillë).

Pasi është marrë një vendim dhe është ngarkuar edhe dokumenti përkatës nga roli AKPT si dhe afati prej 30 ditësh ka përfunduar, PDV në bazë të vendimit të marrë do të kalojë:

1. Tek roli Grupi Punës në Bashki kur vendimi është Refuzim nga AKPT: Refuzo
2. Tek roli Kryetar kur vendimi është Aprovim nga AKPT: Prano

*Sqarim: Në rast se AKPT nuk merr një vendim mbi aplikimin/aplikimet e ardhura brenda 30 ditëve nga momenti që çdo aplikim ka kaluar për shqyrtim tek ky rol, atëherë çdo aplikim do të kalojë me statusin *"Miratim në Heshtje"* tek roli Kryetari i Bashkisë, si dhe do të ketë një dokument të gjeneruar nga sistemi, ku do të shpjegohet se aplikimi në fjalë është miratuar në heshtje nga roli AKPT.

*Me këtë hap përfundon dhe shqyrtimi i një PDV nga ana e AKPT.*

*Ju Faleminderit!*

*www.planifikimi.gov.al*
*info@planifikimi.gov.al*

Modeli i të dhënave gjeohapësinore për hartimin e Planit të Detajuar Vendor është hartuar në shërbim të unifikimit të të dhënave hapësinore të shkallë vendi dhe të sinkronizimit të tyre me të dhënat e përftuara nga hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor.

Modeli përbëhet nga të dhëna për gjendjen ekzistuese dhe për planin e propozimeve, për çdo fushë që mund të nevojitet gjatë hartimit të një PDV-je.

Në rast se për PDV të caktuara, nevojitet paraqitja e të dhënave shtesë, kjo mund të realizohet mbi strukturën e mëposhtme. Për çështje rakordimi, bashkitë duhet të krijojnë komunikim për këtë çështje paraprakisht me AKPT-në, për t'i ofruar orientimet dhe asistencën e nevojshme.

Shtresat e **detyrueshme** për t'u paraqitur, me fushat përkatëse të plotësuara, janë shtresat 10, 12, 13, 14, 15, 16 – të cilat shfaqin propozimet për nënjësitë dhe përdorimin e tokës, infrastrukturën dhe vijat kushtëzuese të zhvillimit.

Shtresat e tjera këshillohen të plotësohen për t'i ardhur në ndihmë punës së brendshme të ekipit hartues në mënyrë databaza të jetë sa më e plotë dhe e integruar.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, pas miratimit të çdo PDV-je, do të ngarkojë informacionin GIS për nënjësitë dhe infrastrukturën e propozuar të PDV-së në platformën elektronike e-harta[1], në mënyrë që publiku të njihet zyrtarisht me të.

Shtresat e të dhënave janë si më poshtë:

## I. Analiza e gjendjes ekzistuese

*A. Përdorimi i tokës:*

1. Ndërtesa
2. Parcela kadastrale
3. Përdorimi ekzistues i tokës

*B. Infrastruktura ekzistuese:*

4. Rrjeti rrugor
5. Rrjeti hekurudhor
6. Infrastruktura energjitike dhe e telekomunikacionit
7. Infrastruktura ujësjellës-kanalizime

*C. Zona me zhvillim të kushtëzuar:*

8. Zona rreziku natyror
9. Zona të mbrojtura nga zhvillimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETAR

[1] Faqja zyrtare e AKPT – www.planifikimi.gov.al > https://akpt.maps.arcgis.com/apps/webappviewer/index.html?id=ff270e99f5be45f19c7b7a1e3e618b27

AKPT
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

## II. Plani i detajuar i zhvillimit

*A. Përdorimi i propozuar i tokës dhe kushtet e zhvillimit:*

10. Nënnjësitë / Përdorimi i propozuar i tokës dhe Kushtet e zhvillimit*

11. Gjurmët e ndërtimit

*B. Infrastruktura e propozuar:*

12. Rrjeti rrugor*

13. Infrastruktura energjitike dhe e telekomunikacionit*

14. Infrastruktura ujësjellës-kanalizime*

*C. Kushtëzimi i zhvillimit:*

15. Vija blu*

16. Vija e kuqe*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARI

* Shtresa të detyrueshme për t'u plotësuar e paraqitur së bashku me materialet e tjera të PDV-së, sipas VKM nr. 686, datë 22.11.2017, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar.

## ANALIZA E GJËNDJES EKZISTUESE

### Grupi i të dhënave : PËRDORIMI I TOKËS

### 1. NDËRTESA (poligon)

Ndërtesat janë të domosdoshme për të vlerësuar zhvillimin aktual në njësi. Për të hartuar PDV-në duhet të kryhet rilevimi në terren dhe të korrektohen gjurmët e ndërtesave. Për secilën ndërtesë (poligon) kryhet azhornimi i të dhënave atribute sipas tabelës së mëposhtme, në gjeodatabazë. Baza për azhornimin është shtresa e ndërtesave ekzistuese, pjesë e databazës së PPV-së.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| Ndërtesa (poligon) | Lartësia në Kate | *nr* |
| | Lartësia në Metra | *nr (m)* |
| | | *null* |
| | Kate nën 0 | *nr* |
| | | *null* |
| | Gjendja Fizike | *E mirë* |
| | | *Mesatare* |
| | | *E keqe* |
| | | *E papërfunduar* |
| | | *E rikonstruktuar* |
| | | *Rrënojë* |
| | Materiali | *Tullë* |
| | | *Beton* |
| | | *Parafabrikat* |
| | | *Çelik* |
| | | *Guri* |
| | | *Druri* |
| | Funksioni Primar | *Lista e Funksioneve* |
| | Funksioni Sekondar | *Lista e Funksioneve* |
| | Periudha e Ndërtimit | *-1945* |
| | | *1945-1960* |
| | | *1961-1980* |
| | | *1981-1990* |
| | | *1991-2000* |
| | | *2001-2010* |
| | | *2010+* |
| | | *Pa informacion* |
| | Viti i Rikonstruksionit | *datë* |
| | | *null* |
| | Statusi Ligjor | *Informale* |
| | | *Formale* |
| | Përdorimi | *E Banuar* |
| | | *E Braktisur* |
| | | *Pa informacion* |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË

| | | |
|---|---|---|
| | Monument | *Kategori I* |
| | | *Kategori II* |
| | | *Nuk aplikohet* |

## 2. PARCELAT KADASTRALE (poligon)

Për hartimin e PDV-së është e domosdoshme të merret dhe punohet me informacionin e saktë të gjendjes ekzistuese të statusit kadastral, dhe informacionet e detajuara rreth zërit kadastral, sipërfaqes, ndërtesave etj. Ky informacion azhornohet (vizatohen poligonet e saktësuara nga rilevimi, dhe azhornohen atributet përkatëse) mbi shtresën e parcelave kadastrale, që gjendet në ASIG. Në rastet kur në listën e atributeve nuk janë parashikuar të gjitha opsionet (p.sh.: lloji i pasurisë është tjetër) atëherë mund të shtohet atributi specifik jashtë listës se mëposhtmë.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| **Parcelat Kadastrale (poligon)** | Numri i Pasurisë | *tekst* |
| | Numri i Zonës Kadastrale | *tekst* |
| | Lloji i Pasurisë | *Ullishte* |
| | | *Arë* |
| | | *Pemëtore* |
| | | *Vresht* |
| | | *Livadh* |
| | | *Kullotë* |
| | | *Pyll* |
| | | *Shkëmbore* |
| | | *Ranishte* |
| | | *Ledh* |
| | | *Shesh* |
| | | *Terren sportive* |
| | | *Truall* |
| | | *Liqen* |
| | | *Lum* |
| | | *Përrua* |
| | | *Kanal* |
| | | *Rrugë* |
| | | *Trotuare* |
| | | *Hekurudhë* |
| | | *Ndërtesë* |
| | | *Varreza* |
| | | *Rezervuar* |
| | | *Tjetër (specifiko)* |
| | Statusi i Pronësisë | *Publik* |
| | | *Privat* |
| | | *Pa informacion* |

| | | |
|---|---|---|
| | Sipërfaqja e Pasurisë | *$m^2$ / nr* |
| | Numri i Ndërtesave | *nr* |
| | Sipërfaqja e Ndërtimit | *$m^2$ / nr* |
| | Nomenklatura e Hartës (1:2500) | *tekst* |

### 3. PËRDORIMI I TOKËS (poligon)

Gjendja ekzistuese e përdorimit të tokës, e shprehur në poligone të veçanta me përdorime homogjene, detajuar në nivel funksioni, sipas shtojcës 1 të VKM nr. 686, dt. 22.11.2017, e ndryshuar. Baza për detajimin e përdorimit në këtë shtresë, është shtresa e përdorimit ekzistues të tokës pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor. Plotësimi i atributeve që lidhen me parametrat e zhvillimit ndihmon në llogaritjet për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave, në fazën e hartimit të propozimeve.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| **Perdorimi Ekzistues i Tokës (poligon)** | Bashkia | *Lista e Bashkive* |
| | Sistemi | *Urban* |
| | | *Infrastrukturor* |
| | | *Bujqesor* |
| | | *Natyror* |
| | | *Ujor* |
| | Kategori | *Kategoritë e Perdorimit të Tokës (Shtojca I, VKM 686)* |
| | Nënkategori | *Nënkategoritë e Përdorimit të Tokës (Shtojca I, VKM 686)* |
| | Funksion | *Funksionet (Shtojca I, VKM 686)* |
| | Intensiteti | *nr* |
| | Ksht | *nr (%)* |
| | Kshp | *nr (%)* |
| | Kshr | *nr (%)* |
| | Tipologjia Hapësinore | *Struktura Individuale (Vila) të Veçuara* |
| | | *Struktura Individuale (Vila) Lineare/Ngjitura* |
| | | *Struktura Individuale (Vila) të Grupuara* |
| | | *Struktura Kolektive (Pallat) të Veçuara, tip Kullë* |
| | | *Struktura Kolektive (Pallat) Lineare/Ngjitura* |
| | | *Struktura Kolektive (Pallat) Paralele* |
| | | *Struktura Kolektive (Pallat) të Grupuara* |
| | | *Mikse - Vila, Pallat Lineare/Ngjitura* |
| | | *Mikse - Vila, Pallat të Grupuara* |
| | | *null* |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETAR

**Grupi i të dhënave : INFRASTRUKTURA**

### 4. RRJETI RRUGOR (vijë)

Kjo shtresë paraqet informacion mbi gjurmën e linjave të rrjetit rrugor. Tipi i gjeometrisë së përdorur është linjë (polyline). Baza për azhornimin dhe detajimin është shtresa e rrjetit rrugor ekzistues pjesë e databazës së Planit të Përgjithshëm Vendor. Në nivelin e PDV-së, duhet të vizatohen të gjitha rrugët ekzistuese në njësi, pavarësisht kategorisë apo gjerësisë së tyre, dhe të plotësohen fushat përkatëse me atribute.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| **Rrjeti Rrugor (vijë)** | Kategoria | *Kategoria A. Autostradë* |
| | | *Kategoria B. Rrugë Interurbane Kryesore* |
| | | *Kategoria C. Rrugë Interurbane Dytësore* |
| | | *Kategoria D. Rrugë Urbane Kryesore* |
| | | *Kategoria E. Rrugë Urbane Dytësore* |
| | | *Kategoria F. Rrugë Lokale* |
| | Gjendja Fizike | *E mirë* |
| | | *Mesatare* |
| | | *E keqe* |
| | | *Rikonstruksion* |
| | Lloji | *Asfalt* |
| | | *Çakëll* |
| | | *Dhè i ngjeshur* |
| | | *Beton* |
| | Viti i Rikonstruksionit | *datë* |
| | | *null* |
| | Trotuare | *Po* |
| | | *Jo* |
| | Korsi | *nr* |
| | Parkim | *Po* |
| | | *Jo* |
| | Gjerësia | *nr (m)* |

### 5. RRJETI HEKURUDHOR (vijë)

Në rastet kur në njësi ekziston rrjeti hekurudhor, në këtë shtresë paraqitet gjurma e linjës hekurudhore. Tipi i gjeometrisë së përdorur është vijë.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| **Rrjeti Hekurudhor (vije)** | Gjendja Fizike | *E mirë* |
| | | *Mesatare* |
| | | *E keqe* |

| | | |
|---|---|---|
| | | *Rikonstruksion* |
| | | *Jo-funksionale* |
| | Viti i Rikonstruksionit | *datë* |
| | | *null* |
| | Gjerësia | *nr (m)* |

## 6/A. INFRASTRUKTURA ENERGJITIKE DHE E TELEKOMUNIKACIONIT (vijë)

Në këtë shtresë paraqitet informacioni mbi linjat ekzistuese të infrastrukturave energjitike dhe të telekomunikacionit, të detajuara për njësinë përkatëse. Tipi i gjeometrisë së përdorur është vijë.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| **Infrastrukturë Energjitike dhe Telekomunikacioni (vijë)** | Kategoria | *Infrastrukturë Energjie Elektrike* |
| | | *Infrastrukturë Gazsjellësi* |
| | | *Infrastrukturë Telekomunikacioni* |
| | Lloji | *Linja Shpërndarëse Energjie Elektrike* |
| | | *Linja Transmetimi Energjie Elektrike* |
| | | *Tubacion Shpërndarës Gazi* |
| | | *Linja Telekomunikacioni Tv* |
| | | *Linja Telefonie* |
| | | *Fibër Optike* |
| | Kapaciteti | *tekst* |
| | Kuota | *Nëntokësore* |
| | | *Mbitokësore* |
| | Buffer | *nr (m)* |

## 6/B. INFRASTRUKTURA ENERGJITIKE DHE E TELEKOMUNIKACIONIT (pikë)

Nga ky shapefile marrim informacion mbi pikat/nyjet ekzistuese të rrjetit të infrastrukturave Energjitike dhe të Telekomunikacionit të detajuara për njësinë përkatëse (Transformator, Shtyllë Elektrike, Antena, etj.). Tipi i gjeometrisë së përdorur është pikë.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| **Infrastrukturë Energjitike dhe Telekomunikacioni (pikë)** | Kategoria | *Infrastrukture Energjie Elektrike* |
| | | *Infrastrukture Gazsjellësi* |
| | | *Infrastrukture Telekomunikacioni* |
| | Lloji | *Kabinë Elektrike* |
| | | *Transformator* |
| | | *Shtyllë Elektrike* |
| | | *Antenë* |
| | Kapaciteti | *tekst* |
| | | *Nuk aplikohet* |
| | Buffer | *nr (m)* |
| | | *Nuk aplikohet* |

## 7/A. INFRASTRUKTURA UJËSJELLËS-KANALIZIME (vijë)

Në këtë shtresë paraqitet informacioni mbi linjat ekzistuese të infrastrukturave të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza, të detajuara për njësine përkatëse. Tipi i gjeometrisë së përdorur është vijë.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| **Infrastruktura Ujesjellës Kanalizime (vijë)** | Kategoria | *Infrastrukture Ujësjellësi* |
| | | *Infrastrukture KUB* |
| | | *Infrastrukture KUZ* |
| | | *Infrastrukture Bujqësore Vaditje-Kullim* |
| | Gjendja | *Mirë* |
| | | *Keq* |
| | | *Mesatare* |
| | | *Rikonstruksion* |
| | Viti i Rikonstruksionit | *datë* |
| | | *null* |
| | Kapaciteti | *tekst* |
| | | *null* |

## 7/B. INFRASTRUKTURA UJËSJELLËS-KANALIZIME (pikë)

Në këtë shtresë paraqitet informacioni mbi pikat/nyjet ekzistuese të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza të detajuara për njësinë përkatëse (pus, depo uji, pikë derdhje, stacion pompimi, pusetë, etj.). Tipi i gjeometrisë së përdorur është pikë.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| **Infrastruktura Ujesjellës Kanalizime dhe Menaxhimi Mbetjesh (pikë)** | Kategoria | *Infrastrukture Ujësjellësi* |
| | | *Infrastrukture KUB* |
| | | *Infrastrukture KUZ* |
| | Lloji | *Pus* |
| | | *Depo Uji* |
| | | *Stacion Pompimi* |
| | | *Puseta* |
| | Kapaciteti | *nr* |
| | | *null* |
| | Buffer | *nr* |
| | | *null* |

**Grupi i të dhënave : ZONA ME ZHVILLIM TË KUSHTËZUAR**

### 8. ZONA RREZIKU NATYROR (poligon)

Në këtë shtresë paraqitet informacioni mbi zonat të cilat rrezikohen nga fatkeqësi natyrore apo problematika të tjera mjedisore (përmbytje, rrëshqitje, ndotje nga mbetje toksike, etj.). Tipi i gjeometrisë së përdorur është poligon. Sipas rastit, mund të shtohen edhe lloje të tjera zonash të cilat konsiderohen me rrezik dhe ku zhvillimi duhet të kufizohet.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| Zona Rreziku Natyror (poligon) | Lloji | *Zona në Rrezik Përmbytjeje* |
| | | *Zona në Rrezik Rrëshqitjeje* |
| | | *Zona të Ndotura nga Mbetje Toksike (Hotspot)* |
| | | *tjetër* |
| | Buffer | *nr (m)* |
| | Përshkrim | *tekst* |

### 9. ZONA TË MBROJTURA NGA ZHVILLIMI (poligon)

Në këtë shtresë paraqitet informacioni mbi zonat në të cilat nuk lejohen zhvillime për arsye sigurie (p.sh.: zonat buffer për infrastrukturë, varreza, etj.). Tipi i gjeometrisë së përdorur është poligon.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| Zona të Mbrojtura nga Zhvillimi (poligon) | Lloji | *Buffer Infrastrukture* |
| | | *Përdorime të Veçanta* |
| | Përshkrim | *Tekst* |

## PLANI I DETAJUAR I ZHVILLIMIT

**Grupi i të dhënave : PËRDORIMI I PROPOZUAR I TOKËS DHE KUSHTET E ZHVILLIMIT**

### 10. NËNNJËSITË - PËRDORIMI I PROPOZUAR I TOKËS DHE KUSHTET E ZHVILLIMIT (poligon)

** Shtresë e detyrueshme për t'u paraqitur*

Në këtë shtresë do të paraqitet nënnjësitë që rezultojnë nga ndarja e njësisë. Për secilin poligon, që përfaqëson një nënnjësi, do të plotësohen fushat e mëposhtme me atributet përkatëse.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| Nënnjësitë - Përdorimi i Propozuar i | Bashkia | *Lista e Bashkive* |
| | Njësia | *Kodi* |
| | Sistemi | *Urban* |

| | | |
|---|---|---|
| **Tokës dhe Kushtet e Zhvillimit (poligon)** | | *Infrastrukturor* |
| | | *Bujqësor* |
| | | *Natyror* |
| | | *Ujor* |
| | Kategori | *Kategorië e Perdorimit të Tokës (Shtojca I, VKM 686)* |
| | Nënkategori | *Nënkategorië e Përdorimit të Tokës (Shtojca I, VKM 686)* |
| | Funksion | *Funksionet (Shtojca I, VKM 686)* |
| | Intensitet | *nr* |
| | Ksht | *nr (%)* |
| | Lartësia (Kate) | *nr* |
| | Lartësia (Metra) | *nr* |
| | Parcela Minimale (1) | *nr* |
| | Kshp | *nr (%)* |
| | Kshr | *nr (%)* |
| | Nr. Banorësh | *nr* |
| | Dendësi | *nr* |
| | Gjelberim / Banor | *nr* |
| | Vendparkime | *nr* |
| | Tipologjia Hapesinore | *Struktura Individuale (Vila) Të Veçuara* |
| | | *Struktura Individuale (Vila) Lineare/Ngjitura* |
| | | *Struktura Individuale (Vila) Të Grupuara* |
| | | *Struktura Kolektive (Pallat) Të Veçuara, tip Kullë* |
| | | *Struktura Kolektive (Pallat) Lineare/Ngjitura* |
| | | *Struktura Kolektive (Pallat) Paralele* |
| | | *Struktura Kolektive (Pallat) Të Grupuara* |
| | | *Vila, Pallat Lineare/Ngjitura* |
| | | *Vila, Pallat Grupuara* |
| | | *tjetër* |
| | Menyra e Nderhyrjes | *Urbanizim* |
| | | *Konsolidim* |
| | | *Konservim* |
| | | *Rigjenerim* |
| | | *Rizhvillim* |
| | | *Dendësim* |
| | Instrumenti | *Intensitet me Kushte* |
| | | *Transferimi i të Drejtës për Zhvillim* |
| | | *Servituti Publik* |
| | | *Zhvillimi i Detyrueshëm* |
| | | *E Drejta e Preferimit* |
| | | *null* |
| | Përdorime të Lejuara | *tekst (sipas Shtojcës I, VKM 686)* |
| | Përdorime të Ndaluara | *tekst (sipas Shtojcës I, VKM 686)* |

| | | |
|---|---|---|
| | Përdorime të Kushtëzuara | *tekst (sipas Shtojcës I, VKM 686)* |
| | Kufizime Ligjore | *tekst (në rast zone të mbrojtur natyrore apo kulturore, zone ku veprojnë vendime të posaçme sektoriale, etj.)* |
| | Përshkrim | *tekst* |

### 11. GJURMËT E NDËRTIMIT (poligon)

Kjo shtresë është opsionale, dhe përdoret sipas mundësisë dhe nivelit të dëshiruar të detajimit të PDV-së. Shërben për të paraqitur gjurmën e ndërtimeve shoqëruar me atributet përkatëse. E lejueshme të shtohen funksione të tjera në rastet kur lista e të dhënave të paracaktuara në datamodel nuk i parashikon.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| **Gjurmët e Ndërtimit (poligon)** | Lartësia në Kate | *nr* |
| | Lartësia në Metra | *nr (m)* |
| | Funksioni Primar | *Lista e Funksioneve* |
| | Funksioni Sekondar | *Lista e Funksioneve* |

## Grupi i të dhënave : INFRASTRUKTURA E PROPOZUAR

### 12. RRJETI RRUGOR I PROPOZUAR (vijë)

** Shtresë e detyrueshme për t'u paraqitur*

Në këtë shtresë duhet të paraqitet rrjeti rrugor i propozuar*, duke plotësuar të gjitha fushat me atributet përkatëse për çdo segment.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| **Rrjeti Rrugor i Propozuar (vijë)** | Kategoria | *Kategoria A. Autostradë* |
| | | *Kategoria B. Rruge Interurbane Kryesore* |
| | | *Kategoria C. Rruge Interurbane Dytësore* |
| | | *Kategoria D. Rruge Urbane Kryesore* |
| | | *Kategoria E. Rruge Urbane Dytësore* |
| | | *Kategoria F. Rruge Lokale* |
| | Lloji | *Asfalt* |
| | | *Çakëll* |
| | | *Dhè i ngjeshur* |
| | | *Beton* |
| | Ndërhyrja | *Ndërtim* |

* Me "e propozuar" nuk nënkuptohet vetëm ajo që do të jetë e re, por situata e plotë e planifikuar, që mund të përfshijë dhe elementë ekzistues. Të gjithë elementët ekzistues që mbarten në plan, duhet të paraqiten edhe në shtresat e propozimeve.

| | | |
|---|---|---|
| | | *Zgjerim* |
| | | *Rikonstruksion* |
| | | *Mirëmbajtje* |
| | Trotuare | *Po* |
| | | *Jo* |
| | Korsi | *nr* |
| | Parkim | *Po* |
| | | *Jo* |
| | Gjerësia | *nr (m)* |

## 13/A. INFRASTRUKTURA ENERGJITIKE DHE E TELEKOMUNIKACIONIT E PROPOZUAR (vijë)

** Shtresë e detyrueshmë për t'u paraqitur*

Në këtë shtresë duhet të paraqiten linjat e propozuara* të infrastrukturave energjitike dhe të telekomunikacionit, të detajuara për njësine përkatese. Tipi i gjeometrisë së përdorur është vijë.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| **Infrastrukturë Energjitike dhe Telekomunikacioni e Propozuar (vijë)** | Kategoria | *Infrastrukture Energjie Elektrike* |
| | | *Infrastrukture Gazi* |
| | | *Infrastrukture Telekomunikacioni* |
| | Ndërhyrja | *Ndërtim* |
| | | *Rikonstruksion* |
| | | *Mirëmbajtje* |
| | Lloji | *Linja Shpërndarëse Energjie Elektrike* |
| | | *Linja Transmetimi Energjie Elektrike* |
| | | *Tubacion Shpërndares Gazi* |
| | | *Linja Telekomunikacioni Tv* |
| | | *Linja Telefonike* |
| | | *Fibër Optike* |
| | Kapaciteti | *Tekst* |
| | Kuota | *Nëntokësore* |
| | | *Mbitokësore* |
| | Buffer | *nr (m)* |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

## 13/B. INFRASTRUKTURA ENERGJITIKE DHE E TELEKOMUNIKACIONIT E PROPOZUAR (pikë)

** Shtresë e detyrueshmë për t'u paraqitur*

Në këtë shtresë duhet të paraqiten pikat/nyjet e propozuara* të rrjetit të infrastrukturave Energjitike dhe të Telekomunikacionit të detajuara për njësine përkatëse (Transformator, Shtyllë Elektrike, Antena, Stacion Telekomunikacioni, etj.). Tipi i gjeometrisë së përdorur është pikë.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| Infrastrukturë Energjitike dhe Telekomunikacioni (pikë) | Kategoria | *Infrastrukture Energjie Elektrike* |
| | | *Infrastrukture Gazi* |
| | | *Infrastrukture Telekomunikacioni* |
| | Ndërhyrja | *Ndërtim* |
| | | *Rikonstruksion* |
| | | *Mirëmbajtje* |
| | Lloji | *Kabinë Elektrike* |
| | | *Transformator* |
| | | *Shtyllë Elektrike* |
| | | *Antenë* |
| | Kapaciteti | *tekst* |
| | | *Nuk aplikohet* |
| | Buffer | *nr (m)* |
| | | *Nuk aplikohet* |

## 14/A. INFRASTRUKTURA UJËSJELLËS-KANALIZIME E PROPOZUAR (vijë)

** Shtresë e detyrueshmë për t'u paraqitur*

Në këtë shtresë duhet të paraqiten linjat e propozuara* të infrastrukturave të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza, të detajuara për njësine përkatëse. Tipi i gjeometrisë së përdorur është vijë.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| Infrastruktura Ujesjelles-Kanalizime e Propozuar (vije) | Kategoria | *Infrastrukture Ujësjellesi* |
| | | *Infrastrukture KUB* |
| | | *Infrastrukture KUZ* |
| | | *Infrastrukture Bujqesore Vaditje-Kullim* |
| | Nderhyrja | *Ndërtim* |
| | | *Zgjerim* |
| | | *Rikonstruksion* |
| | | *Mirëmbajtje* |
| | Kapaciteti | *tekst* |
| | | *Nuk aplikohet* |
| | Kuota | *nr (m)* |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

* Me "e propozuar" nuk nënkuptohet vetëm ajo që do të jetë e re, por situata e plotë e planifikuar, që mund të përfshijë dhe elementë ekzistues. Të gjithë elementët ekzistues që mbarten në plan, duhet të paraqiten edhe në shtresat e propozimeve.

## 14/B. INFRASTRUKTURA UJËSJELLES-KANALIZIME E PROPOZUAR (pikë)

** Shtresë e detyrueshmë për t'u paraqitur*

Në këtë shtresë duhet të paraqiten pikat/nyjet e propozuara* të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të detajuara për njësinë përkatëse (pus, depo uji, stacion pompimi, puseta, etj.). Tipi i gjeometrisë së përdorur është pikë.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| Infrastruktura Ujesjellës Kanalizime e Propozuar (pike) | Kategoria | *Infrastrukture Ujësjellesi* |
| | | *Infrastrukture KUB* |
| | | *Infrastrukture KUZ* |
| | Ndërhyrja | *Ndërtim* |
| | | *Zgjerim* |
| | | *Rikonstruksion* |
| | | *Mirëmbajtje* |
| | Lloji | *Pus* |
| | | *Depo Uji* |
| | | *Stacion Pompimi* |
| | | *Puseta* |
| | Kapaciteti | *tekst* |
| | | *Nuk aplikohet* |
| | Buffer | *tekst* |
| | | *Nuk aplikohet* |

## Grupi i të dhënave : KUSHTËZIMI I ZHVILLIMIT

## 15. VIJA BLU (vijë)

** Shtresë e detyrueshmë për t'u paraqitur, kur në njësi ka burime ujore*

Në këtë shtresë duhet të paraqitet vija blu (vija mbrojtëse përgjatë elementeve ujore), e cila përcakton kufirin e lejuar për ndërtimet në afërsi të burimeve ujorë.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| Vija Blu (vijë) | Distanca | nr (m) |

* Me "e propozuar" nuk nënkuptohet vetëm ajo që do të jetë e re, por situata e plotë e planifikuar, që mund të përfshijë dhe elementë ekzistues. Të gjithë elementët ekzistues që mbarten në plan, duhet të paraqiten edhe në shtresat e propozimeve.

## 16. VIJA E KUQE (vijë)

** Shtresë e detyrueshmë për t'u paraqitur*

Në këtë shtresë duhet të paraqitet vija e kuqe, e cila përcakton kufirin e lejuar për ndërtimet në raport me akset rrugore.

| Shtresa | Fusha | Atributi |
|---|---|---|
| Vija e Kuqe (vijë) | Distanca | nr (m) |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA